



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**NGA SEANCA SOLEMNE TË KUVENDIT TË KOSOVËS
ME RASTIN E KATËRVJETORIT TË SHPALLJES SË PAVARËSISË SË
REPUBLIKËS SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 16 SHKURT 2012**

**SA SVEĆANE SEDNICE SKUPŠTINE
POVODOM ČETVOROGODIŠNJICE PROGLAŠENJA NEZAVISNOSTI
REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE 16. FEBRUARA 2012. GODINE**

**SHKURT – FEBRUAR
2012**

E enjte, më 16 shkurt 2012

Drejton seancën: Kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI, JAKUP KRASNIQI: Të nderuar deputetë,
E nderuara presidente e Republikës së Kosovës, zonja Atifete Jahjaga,
I nderuari kryeministër i Republikës së Kosovës, zoti Hashim Thaçi,
Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra të kabinetit qeveritar,
Të nderuar përfaqësues të institucioneve ndërkombëtare në Kosovë,
Të nderuar ambasadorë dhe përfaqësues të misionëve diplomatike në Kosovë,
Të nderuar zonja dhe zotërinj të pranishëm,
Qytetarë të Republikës së Kosovës,
Mirë se keni ardhur në seancën solemne të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e thirrur
me rastin e kremtes së katërvjetorit të shpalljes së pavarësisë së Kosovës!

(Intonohet himni i Republikës së Kosovës)

Të nderuar përfaqësues të institucioneve të Republikës së Kosovës,
Të nderuar përfaqësues të institucioneve ndërkombëtare në Kosovë,
Të nderuar ambasadorë dhe përfaqësues diplomatikë në Kosovë,
Të nderuar mysafirë,
Të nderuar kolegë deputetë dhe deputete,
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Zonja dhe zotërinj,

Kam nderin e veçantë t'ju drejtohem me këtë fjalë rasti në shënim të përvjetorit të shpalljes së pavarësisë së Kosovës.

Republika e Kosovës i mbush katër vjet të jetësimit të saj. Shpallja e Pavarësisë së Kosovës në këtë sallë, më 17 shkurt të vitit 2008 ishte një akt historik dhe sublimues i luftërave të pareshtura të shumë brezave për liri dhe mëvetësi shtetërore të vendit tonë. `

Mosha e shtetit të Kosovës është e re, por ideali i popullit të tij për liri e pavarësi është i vjetër. Ky ideal frymëzoi e mobilizoi ndër dekada e shekuj bijat e bijtë më të mirë të kësaj toke, të cilët u nisën rrugës së vështirë, por të lavdishme për t'u bërë theror të lirisë. Jeta është çmimi më i lartë për çdo njeri, por që ia vlen të sakrifikohet për një kauzë të lartë siç është çlirimi i një populli.

Sot është dita e nderimit deri në përkulje për ata që i vunë gjoksin stuhive e rrebesheve të historisë dhe vendosën themelet e Kosovës së lirë, të pavarur dhe demokratike.

Gjej këtë rast solemn t'u shpreh mirënjohje të thellë gjithë miqve tanë ndërkombëtarë, në krye me Shtetet e Bashkuara të Amerikës e të Bashkimit Evropian dhe vendeve anëtare të NATO-s që u vunë në anën e së drejtës dhe bënë të mundur çlirimin e shpejtë dhe pavarësimin e Kosovës, rindërtimin dhe demokratizimin e saj, afirmimin ndërkombëtar dhe njohjen nga afro nëntëdhjetë vende anëtare të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Kosova duhej çliruar sepse e meritonte lirinë. Historia e saj është histori e luftërave të drejta për liri. Kosova duhej të shpallej e pavarur, sepse kishte derdhur gjakun lumë për pavarësinë dhe kishte fituar, sepse ky ishte vullneti i qytetarëve të saj.

Kosova e cilësuar me numër, më 17 shkurt u pagëzua me emrin e saj të plotë e të merituar: Republikë e pavarur, sovranë dhe demokratike. Ky emër i shkruar me gjak në fushëbetejat epike, në shkolla e shtëpi, në mure e në ballë, në zemër e në qelitë e errëta, merr përmasat e shenjtërisë që nuk lejon të preket, sepse lëndohet historia dhe lëkundën eshtrat e dëshmorëve.

Të bashkuar rreth këtij emri dhe këtij amaneti, ne duhet të ndjekim në unitet e unision vijat e pentagramit të historisë, të bëra me gjakun e derdhur.

Kosova gjatë këtyre katër viteve të pavarësisë ka bërë hapa të mëdhenj drejt ndërtimit e konsolidimit të shtetit demokratik, drejt ngritjes së institucioneve shtetërore, drejt fuqizimit të subjektivitetit ndërkombëtar e zhvillimit të gjithanshëm shoqëror dhe ekonomik, por si çdo fillim, e sidomos ai i jetës së pavarur të popujve të sapo dalë nga luftërat çlirimtare, është i vështirë.

Ja përse Kosovës, sikur në luftë edhe sot, i duhen energjitë e potencialet e bashkuara për të arritur hapin e kohës dhe për të zënë proceset historike, nëpër të cilat po kalon rajoni ynë.

Ne duhet t'i mësojmë fëmijët tanë, jo vetëm ta duan vendin e tyre të shenjtë, por të përgatiten për të bërë punë dhe vepra të mëdha për të. E ardhmja e vendit tonë është në duart tona dhe duhet ndërtuar me duart tona.

Duke qenë historia njerë ndaj nesh, zakonisht jemi vonuar në histori. Kosova u pavarësua e fundit nga subjektet konstituive të Federatës së Jugosllavisë. Tashti, jo vetëm që nuk kemi më kohë për të humbur, por duhet kompensuar hapat e munguar. Vetëm duke dyfishuar ritmet e zhvillimit historik, Kosova mund të barazohet me vendet e lira prej kohësh, vetëm duke shfrytëzuar gjithë potencialin dhe vlerat e saj mund të hyjë denjësisht dhe kokëllartë në familjen e integruar evropiane, atje ku e ka vendin gjeografikisht, historikisht, politikisht dhe kulturalisht.

Por, të vonuar janë edhe fqinjët tanë. Ky fakt duhet të na motivojë që energjitë tona të përbashkëta t'i fokusojmë në të ardhmen më të mirë të popujve dhe vendeve tona, e të mos i shpenzojmë ato për të penguar njëri-tjetrin.

Dialektika e historisë do të gjejë rrugët e përparimit, duke mënjeluar pengesat dhe duke hedhur tej përfaqësuesit e së kaluarës së hidhur historike. Në gjithë Gadishullin tonë po bëhet zotëruar ideali i integritetit midis kombeve dhe vendeve.

Realiteti i ri i krijuar në Ballkan, sidomos pas Luftës çlirimtare të Kosovës solli në këtë pjesë të Evropës prezencën ushtarake të NATO-s. Vendosmëria e këtij institucioni të rëndësishëm të sigurisë globale, për të mos lejuar përsëritjen e historisë tragjike, luan një rol të madh në zhdukjen e të gjitha tendencave luftënxitëse në rajonin tonë.

Shekulli XXI kërkon qasje të re në raportet e politikave të jashtme dhe të brendshme të shteteve ballkanike. Kjo qasje duhet të mbështetet në vlerat euroatlantike, duke nxjerrë konkluzione të drejta mbi të kaluarën e hidhur, duke zëvendësuar urrejtjen ndëretnike e

shovinizmin me respektin reciprok, etnocentrizmin me solidaritetin, ekskluzivitetin me integritet, mosdurimin nacional me diversitetin etnik, kulturor, gjuhësor e fetar, si pasuri vlerash demokratike. Për të ndodhur kjo kthesë, rajonit tonë i duhen liderë që kanë vullnetin dhe guximin për të ndërtuar vizionin e vlerave evropiane.

Në këtë përvjetor vjen fuqishëm zëri i kushtrimit nga vitet e rezistencës dhe nga vargu i pambarim i dëshmorëve të lirisë, vjen thirrja amanet e kryetrimt tonë legjendar komandantit Adem Jashari për të mbrojtur fitoret historike, për të kultivuar vlerat e traditës së shkëlqyer të popullit tonë dhe për të përparuar e zhvilluar vendin e të parëve tanë.

Para nesh është beteja e madhe e zhvillimit ekonomik, e zhdukjes së varfërisë, e zhvillimit demokratik dhe e sundimit të plotë të ligjit e të rendit në shoqëri.

Kosova po hyn në vitin e pestë të pavarësisë, si shtet modern evropian, demokratik dhe me respekt e njohje të gjerë ndërkombëtare. Ajo përbën sot një faktor shumë të rëndësishëm paqëndrues dhe bashkëpunues në rajonin tonë dhe më gjerë.

Katër vjet pas shpalljes së pavarësisë, me institucionet e konsoliduara demokratike, me sistemin modern kushtetues, me subjektivitet të sforcuar ndërkombëtar, me ritmet e zhvillimit progresiv dhe me rezultatet legjislativë që e obligonin ndërkombëtarisht Kosovën ne jemi nga fundi i fazës së mbikëqyrjes së pavarësisë dhe të vendosur në trasenë e perspektivës së sigurt të vendit tonë, por edhe me plot sfida të brendshme e të jashtme.

Për gjithë mot, Kosova e lirë, e pavarur, sovranë dhe demokratike!
Ju faleminderit për vëmendjen!

(Duartrokitje)

Të nderuar të pranishëm,
Tani ftoj presidenten e Republikës së Kosovës, zonjën Atifete Jahjaga për një fjalë rasti.
Presidente, e keni fjalën!

PRESIDENTJA E KOSOVËS ATIFETE JAHJAGA: I nderuari kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës,
I nderuari kryeministër,
Të nderuar deputetë,
Të nderuar zëvendëskryeministra e ministra,
Të nderuar ambasadorë të vendeve mike në Kosovë,
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Përvjetori i katërt i kremtimit të pavarësisë së vendit, si realizim i një ëndrre dhe i përpjekjeve shekullore, e gjen Kosovën shtet sovran dhe të pavarur, me njohje nga 87 vende të botës dhe me një vizion e një rrugë të qartë në procesin e integriteteve euroatlantike.

Liria dhe pavarësia e vendit janë gërshetim i të gjitha përpjekjeve tona ndër breza që të jetojmë të lirë, të barabartë dhe të denjitetshëm.

Ideja jonë filozofike dhe politike për Lirinë dhe Pavarësinë e Kosovës ishte gjithmonë ide humane, duke u bërë një rilindje në mendimin kritik, një origjinalitet në mendimin dhe veprimin politik, një gërshetim i urtësisë si mençuri dhe përgjegjësi, një platformë largpamëse si strategji dhe si veprim e sjellje pragmatike, duke i shfrytëzuar të gjitha potencialet dhe kapacitetet, duke vënë në përdorim përvojën nga tradita jonë e pasur, të plotësuar me idetë bashkëkohore filozofike e politike, si ndërtim i një shoqërie të re, që solli mirëkuptimin dhe përkrahjen ndërkombëtare për kauzën tonë të drejtë dhe që, si asnjëherë më parë, solli frytet që ne sot po e gëzojmë Republikën e Kosovës shtet sovran dhe të pavarur, shoqëri demokratike të të gjithë qytetarëve, në miqësi të përjetshme me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me rrugën e qartë e prosperuse të anëtarësimit në Bashkimin Evropian dhe në NATO.

Siç na uron sot Sekretarja Amerikane e Shtetit, Hilari Klinton, Shtetet e Bashkuara të Amerikës si mike dhe si partnere, do të jenë me ne, për të mbështetur sigurinë, paqen dhe prosperitetin e Kosovës.

Të nderuar,

Për Kosovën shtet sovran dhe të pavarur u sakrifikuan bijtë dhe bijat më të mira të vendit tonë që ne jemi të nderuar ti përmendim në çdo manifestim dhe përvjetor.

Kjo ditë na bënë të ndjehemi krenarë për rrugën e mundimshme dhe përplot sakrifica që e kemi kaluar. Na bënë që sot, duke vlerësuar të arriturat tona, të kujtojmë të gjithë ata që sakrifikuan, që ranë në altarin e lirisë dhe që u shkrinë duke punuar për të mirën e popullit dhe të atdheut, për të qenë ne sot të lirë dhe sovranë në trojet tona, për ta ndërtuar Kosovën shtet të lirë e të pavarur.

Të kujtojmë këtu dy figurat emblematike, Presidentin historik doktor Ibrahim Rugovën dhe komandantin legjendar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Adem Jashari, dy simbole këto udhërrëfyese për të tashmen dhe për të ardhmen tonë.

Udhëheqësit tanë, në kohët më të vështira, ditën të marrin vendime të rëndësishme që i përcaktuan kahet e historisë, por e përcaktuan edhe fatin tonë si popull dhe fatin e atdheut tonë.

Duke e nderuar të kaluarën tonë, e nderojmë sakrificën, e nderojmë edhe të tashmen dhe të ardhshmen tonë, sepse programi politik rreth të cilit u bashkuam ishte i drejtë, human, largpamës, i bazuar në traditat më të mira të popullit tonë, në vlerat civilizuese evropiane, duke na përcaktuar fuqishëm në familjen e popujve të Evropës, duke u rikthyer në civilizimin të cilit gjithmonë i kemi përkitur dhe nga i cili, padrejtësisht, jemi ndarë për një kohë të gjatë.

Ne të gjithë tash e kemi më lehtë, sepse rruga është trasuar, parimet janë ndërtuar, dilemat historike janë hequr dhe neve na përket që vetëm konkretisht të marrim hapat për realizimin e strategjisë dhe platformës tonë shtetërore e qytetare.

Në këtë rrugë ne nuk ishim vetëm. Patëm përkrahjen e pakursyer të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të vendeve të Bashkimit Evropian dhe të NATO-s, që bëri intervenimin ushtarak humanitar për të shpëtuar një popull.

Për këtë, Pavarësia e Kosovës është proces i pakthyeshëm dhe nuk ka alternativë. Ne jemi faktorë paqeje e stabiliteti në rajon dhe më gjerë, që zhvillojmë marrëdhënie të mira bilaterale dhe fqinjësore, duke dhënë një shembull të mirë të bashkëpunimit dhe të respektit të ndërsjellë.

Kosova e ka ndërtuar subjektivitetin e vet ndërkombëtar e përfaqësohet dhe do të përfaqësohet e barabartë e me reciprocitet të plotë.

Proceset nuk kthehen mbrapa dhe askush nuk mund të krijojë përshtypjen se procesi i pavarësisë së Republikës së Kosovës nuk është përfunduar.

Republika e Kosovës është e ndërtuar në parimin qytetar, me liri dhe të drejta të barabarta për të gjithë njerëzit. Të gjitha etnitë e Kosovës i gëzojnë të drejtat e tyre të plota kombëtare, pa marrë parasysh numrin e tyre. Kjo është vlerë e jona e ndërtuar tradicionalisht, duke respektuar dhe nderuar njëri-tjetrin.

Të gjithë qytetarët e Kosovës, pa dallim, bashkohen në vizionin e anëtarësimit të plotë në Bashkimin Evropian. Në familjen e popujve me standarde të larta të lirive dhe të drejtave, të proceseve demokratike, të një sistemi të avancuar shkollor, shëndetësor dhe të politikave sociale. Me një ekonomi moderne, në funksion të zhvillimit të përgjithshëm, duke shfrytëzuar të arriturat shkencore dhe duke u transformuar e përshtatur nevojave të njerëzve dhe të kohës.

Vendi ynë ka potenciale të mëdha zhvillimi, duke shfrytëzuar me plan resurset tona natyrore, por ne jemi krenarë sidomos për rininë tonë atdhedashëse të shkolluar, e të brumosur me dije dhe aftësi që janë të standardeve më të larta evropiane. Duke krijuar një ambient të favorshëm, krahas ndërtimit të infrastrukturës moderne rrugore, hekurudhore dhe të transportit ajror, vendi ynë bëhet i përshtatshëm për investime të huaja, për tërheqjen e kapitalit dhe për ndërlidhjen e ekonomisë tonë me ekonominë botërore.

Qytetarët dhe subjektet politike të Kosovës u dëshmuan për tolerancë dhe mirëkuptim, për respektimin e rregullave dhe të ligjit, duke ndërtuar koalicione qeverisëse efikase, duke pasur opozitë konstruktive dhe duke ndërtuar kohezion dhe unitet, duke i vënë në funksion të proceseve demokratike dhe shtet ndërtuese.

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qeveritarë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Në telegramin e urimit që na erdhi sot nga sekretarja e Shtetit Clinton, thuhet se: Edhe pse është një shtet i ri, Kosova është vend që ka një të ardhme premtuese dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë të përkushtuara ta mbështesin një Kosovë të pavarur,

sovrane dhe shumetnike. Sekretarja Klinton i përshëndet përpjekjet e udhëheqësve të zgjedhur për përkushtimin dhe realizmin e aspiratave të qytetarëve të Kosovës dhe për institucione më të fuqishme demokratike, perspektivë më të madhe ekonomike dhe vendosjen e sundimit të rendit dhe të ligjit.

Kjo rrugë do ta çojë Kosovën në integrimin e plotë euroatlantik, në stabilitet të qëndrueshëm dhe prosperitet për vendin tonë.

Katërvjetori i shpalljes së pavarësisë është një festë që na jep kurajë, na mobilizon dhe na nxitë që gjithmonë dhe në çdo rast të jemi në shërbim të popullit dhe vendit tonë.

Ne e meritojmë një të ardhme më të mirë. Ne po punojmë për një të ardhme më të mirë. Ne do ta bëjmë realitet ëndrrën tonë, sepse e kemi vullnetin, e kemi guximin, e kemi përkushtimin dhe e kemi përkrahjen e miqve tanë ndërkombëtarë.

Ky është misioni ynë, të cilin do ta përmbushim bashkërisht.

Ju faleminderit dhe le ta gëzojmë katërvjetorin e pavarësisë!

(Duartrokitje)

KRYETARI: Faleminderit, presidente!

Ftoj kryeministrin e Republikës së Kosovës, zotin Hashim Thaçi për fjalë rasti.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: E nderuara presidente e Republikës së Kosovës, zonja Jahjaga,
I nderuari kryeparlamentar, Krasniqi,
Të nderuar deputetë,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar ambasadorë,
Të nderuar mysafirë,
Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Sot Kosova po shënon ditën e cila është rrënjësuar thellë në kujtesën e të gjithë prej nesh në këtë sallë, por edhe në kujtesën tonë kolektive si popull, si komb dhe si qytetërim.

Sot po shënojmë në mënyrë solemne katër vjetorin e kurorëzimit të rrugëtimit tonë shekullor - shpalljen e Kosovës shtet i pavarur dhe sovran.

Katër vite më parë, ne të zgjedhurit e popullit të Kosovës në Parlamentin e Kosovës, shpallëm Kosovën të pavarur dhe sovranë.

17 shkurti i vitit 2008, është ngjarja më kulmore historike për Kosovën dhe qytetarët e saj. Ëndrrën bashkërisht e bëmë realitet. Për të mbërritur deri festa e madhe e pavarësisë së Kosovës, të gjithë ne së bashku punuam dhe sakrifikuam shumë. Sot kujtojmë presidentin Rugova, komandantin Adem Jashari, gjithë komandantët, ushtarët, luftëtarët,

dëshmorët dhe heronjtë Kosovës.

Vizionin tonë të përbashkët dhe universal për liri, shtet dhe demokraci të atdheut tonë, e realizuam bashkërisht, me unitet të qëndrueshëm politik dhe qytetarë.

Republika e Kosovës është një tregim i suksesshëm me të cilin krenohemi të gjithë, por edhe miqtë tanë.

Në vitin e katërt të pavarësisë, Kosova ka shënuar suksese të njëpasnjëshme në rrafshin politik, diplomatik dhe të zhvillimit ekonomik.

Në katër vjetorin e shënimit të Ditës së Pavarësisë, Kosova është shtet edhe më i konsoliduar, me institucione stabile dhe efektive me qeverisje të mirë, sundim të rendit dhe ligjit, si dhe respektim afirmativ të komuniteteve.

Sot Republika e Kosovës është e njohur nga 87 shtete të botës, dhe ka hapur procesin e dialogut për liberalizimin e vizave, duke bërë hapa konkretë në perspektivën e integritimeve evropiane.

Zonja dhe zotërinj,

Ne të gjithë së bashku ndihemi krenarë, ashtu si e arritëm pavarësinë e vendit tonë, bashkërisht po punojmë edhe sot çdo ditë për zhvillimin dhe integrimin e Republikës sonë në institucionet euro-atlantike.

Bashkimi Evropian nuk është vetëm mekanizëm politik, por mbi të gjitha është bashkim i sistemit të vlerave dhe ne si shoqëri dhe si shtet i synojmë po ato vlera, po atë vizion - ndërtimin e Kosovës Evropiane.

Secili qytetar i Kosovës duhet të ndihet mirë dhe krenar për kontributin e tij në realizimin e këtij vizioni.

Viti 2012 është vit i përmbylljes së pavarësisë së mbikëqyrur, si shenjë e arritjes së standardeve demokratike. Prandaj, falënderoj edhe përfaqësuesin e ICO-së zotin Piter Faith, për mbështetjen në zotimin e institucioneve të Kosovës për përmbylljen e këtij procesi suksesshëm.

Institucionet ndërkombëtare që janë të pranishme në Kosovë kanë mbështetur fuqishëm agjendën që çon drejt kësaj përmbylljeje.

Prandaj sot, shfrytëzoj rastin për t'i falënderuar për bashkëpunim dhe kontributin e tyre në forcimin e shtetit të Kosovës.

Falënderojmë shtetet anëtare të Grupit Ndërkombëtare Drejtues, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, shtetet e Bashkimit Evropian, NATO-n dhe të gjitha institucionet tjera që e mbështesin vendin tonë.

Zonja dhe zotërinj,
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Me përkushtimin tonë të vazhdueshëm institucional, me filozofinë e qeverisjes së mirë dhe të përgjegjshme, brenda katër vjetësh ne e zhvilluam edhe më shumë vendin tonë.

Krijuam më shumë vende të reja të punës, përmirësuam infrastrukturën e përgjithshme kudo në Kosovë. Një pjesë e autostradës moderne Vërmicë - Merdar, duke përmbushur kriteret më të larta, u përfundua në afat rekord.

U ngritën pagat substancialisht për të gjitha kategoritë sociale, në arsim, shëndetësi, polici, familje të dëshmorëve dhe invalidëve të luftës, për pjesëtarë të FSK-së, pensionistë, shërbyesit civilë dhe për të gjithë bartësit e institucioneve vitale të shoqërisë.

Përmirësimi i cilësisë së jetës së qytetarëve tanë, vazhdon të jetë preukopim dhe objektiv i yni themelor.

Të nderuar deputetë,
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Në ditën e shënimit të pavarësisë së Kosovës, ne kujtojmë të kaluarën e ndritur të vendit tonë. Ne kujtojmë përpjekjet një shekullore të popullit tonë për liri dhe pavarësi. Përvjetori i katërt i pavarësisë së Kosovës, përkon edhe me 100 vjetorin e pavarësisë së Shqipërisë, një ngjarje madhore kjo për kombin shqiptar në shekullin e kaluar.

Në ditën si kjo, nderojmë dëshmorët tanë, ata që dhanë më të shtrenjtën për lirinë e vendit tonë.

Po ashtu, shprehim nderimin dhe respektin e lartë për heronjtë e gjallë të këtij vendi: punëtorët, fermerët, veteranët, invalidët, mësuesit, mjekët, artistët, ushtarët, policët, pensionistët, të rinjtë dhe të rejat, pleqtë dhe fëmijët që në çdo orë dhe në çdo kohë e pasurojnë dhe e begatojnë jetën tonë dhe shtetin tonë të ri. Kosova është shtet i ri, por është shtet i mundësive të mëdha, është shtet i mundësive të jashtëzakonshme.

Të gjithë qytetarët e Kosovës, pa dallim, kontribuan për lirinë, çlirimin dhe pavarësinë e Kosovës.

Një mirënjohje dhe falënderim i veçantë për diasporën kosovare kudo që gjendet, në Evropë, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe vende tjera.

Të nderuar deputet,
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Ftoj qytetarët e Republikës së Kosovës që të festojnë me dinjitet dhe krenari, sepse ashtu edhe e meritojnë. Kosova është atdheu i gjithë qytetarëve të saj.

Kjo është festë që na jep energji të re, festë që na bashkon dhe forcon të gjithëve .

Përderisa dje sfidë kryesore ishte mbijetesa, çlirimi dhe pavarësia, sfidat e së ardhmes sonë janë zhvillimi dhe integrimi.

Ne nuk do të ndalemi së punuari për realizimin e projektit madhor që qytetarët tanë të jenë të barabartë me ata të Bashkimit Evropian. Pra shteti i Kosovës të anëtarësohet sa më shpejt në NATO dhe Bashkim Evropian.

Faleminderit dhe urime të gjithëve katër vjetori i Pavarësisë së Kosovës!

KRYETARI I KUVENDIT: Faleminderit, kryeministër!

Të nderuar qytetarë,
Urime festa e pavarësisë!

Të nderuar të pranishëm, ju falënderoj për pjesëmarrje në festën e pavarësisë.

Me kaq edhe i përmbylлим punimet e kësaj seance solemne. Ju faleminderit!

E përqatiti:

Njësia për Transkriptim dhe Lekturë e Kuvendit të Kosovës